VENDIM
Nr. 899, datë 12.12.2012

PËR KOMPENSIMIN E VLERËS SË TAKSËS SË BIZNESIT TË VOGËL, TË PËRDORUR PËR RIMBURSIMIN E PAJISJEVE FISKALE E TË TAKSIMETRAVE, PËR 8 BASHKI DHE 30 KOMUNA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit te Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e vlerës se taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e vlerës së pajisjeve fiskale e të taksimetrave, për njësitë e qeverisjes vendore, për 8 bashki dhe 30 komuna, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Fondi, në vlerë 32 503 857 (tridhjetë e dy milionë e pesëqind e tri mijë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë, të përballohet nga Fondi i Kontingjencës, i miratuar në buxhetin e vitit 2012.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha